



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-23425/2019

Klinë, 30. 04. 2019

EKSTRAT-PROCESVERBAL

I Seancës së IV-të, të rregullt, të punës së Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur më 30. 04. 2019, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Seancën e IV-të, të rregullt të punës së Kuvendit të Komunës së Klinës e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të pranishmit në seancë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Më lejoni që të hap mbledhjen e IV-të, të KK, duke ju uruar mirëseardhje të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive, OSBE, KFOR, mediave. Përshëndetje për komandantin e Policisë, qytetarë pjesëmarrës. Konstatoi që prezent jemi 26 anëtarë të Kuvendit dhe se mund të fillojnë punimet e mbledhjes së IV të rregullt të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu mund të procedojmë me rendin e ditës por që paraprakisht unë dua ta paraqes një propozim. Pika 7 e Rendit të Ditës dhe Pika 8, propozoj që të hiqen nga rendi I ditës pasi që te pika e 7. Ne jemi në përfundim të përgatitjeve të hartave zonale, kompania është në përfundim e sipër dhe shumë shpejt do të na vije në seancë proceduralisht. Kemi marr një shkresë nga Ministria e Ambientit që nuk mund të bëjmë asnjë ndryshim parcele derisa të bëhet ndërrimi proceduralisht I kërkuar I hartave zonale. Ndërsa për piken e 8. Ne e kemi debatuar edhe në KPF dhe thënë të vërtetën nuk e di se si na ka depërtuar kjo, por këtë Komision e kemi themeluar në vitin 2018. Tani është hy në fuqi edhe ndryshimi I ligjit të ri, I cili thotë se për çdo kërkesë për dhënie apo këmbim të pronës së Komunës duhet të formohet Komision I veçantë. Mund ta lejmë kështu këtë Komision porse duhet ta mandatojmë sa herë të ketë kërkesë të re ose duhet formuar Komision I ri sa herë të ketë kërkesë të re. Pra janë këto dy pika që propozoj që të hiqen nga Rendi I Ditës. Hap debat për rendin e Ditës.

z. Avni Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Dëshiroi që të lexoi një Deklaratë para se të votojmë rendin e Ditës. Qytetaret e Klinës përmes votës se lirë na kanë dhënë besimin që në rolin e pozitës apo opozitës të jemi zëri I tyre në Kuvendin komunal të Klinës, të ndajmë buxhetin, të marrim vendime për zgjidhjen e halleve të tyre por edhe të kritikojmë dhe ofrojmë zgjidhje aty ku e shohim të arsyeshme. Pra, Kuvendi është vendi ku ne jemi të thirrur të ngrisim zërin e qytetarëve, pa përjashtuar edhe format tjera. Po I them këto sepse qytetarët e Klinës janë duke na dëgjuar direkt përmes Radio Albës dhe duhet të ja rikujtojmë edhe njëherë se pse opozita u obligua që të lëshoj seancën e marsit. Edhe ne kemi mundësi që të japim deklarata ne Radio Alba, e të bëjmë postime në Facebook, siç bëri pozita me shtrembërimin

e së vërtetës për lëshimin e seancës nga opozita, muajin e kaluar. Por, Jo, as nuk kam postuar në facebook dhe as nuk kam dhënë ndonjë koment në lidhje me këtë, sepse krejt çka kam pasur dhe kam për ta thënë, fillimisht do ta përdori foltoren e Kuvendit. E nëse këtu s'mund të gjejë përkrahje, vazhdojmë me opsionet tjera! Pra, të nderuar kolegë, nuk ishte se unë nuk e kam respektuar procedurën për parashtrimin e kërkesës për formimin e Komisionit siç thoshte kryesuesi i Kuvendit dhe kolegja nga radhët e LDK-së, Violeta Zefi, as nuk ishte humbje kohe siç thoshte kolegu, Sefë Morina, e aq më pak nuk kishte arsye për formimin e komisionit për punimet e papërfunduara që thoshte drejtori i Urbanizimit: "ku keni pa të formohen komisione pa u krye punimet"- thoshte Lorenci, në seancën e kaluar. Por ishte komplet e kundërta që më kishte shtyrë të kërkoj formimin e komisionit për hulumtimin e punimeve të kryera dhe ato që kishin mbetur përgjysmë, punimet e kryera shkel e shko, pa plotësim të kriterëve elementare, pa përgatitje të trasesë, pa ngjeshje adekuate ma valak e shumë elemente tjera të ngritura edhe nga kolegu, Gjokë Lleshaj, në interpelancë më drejtorin. Pavarësisht këtyre problemeve të evidentuara gjatë punimeve, çuditërisht pranohen teknikisht nga drejtori dhe komisioni i Komunës, dhe paguhen mbi 70. 000 euro nga Komuna, në muajin dhjetor. Kjo më ka shtyrë që të bëj çka është e mundur përmes rrugëve ligjore për të identifikuar problemet, sanuar gabimet dhe të krijojmë një bazë si Komunë për të mos i përsëritur këto gabime, nëse mund ti themi gabime! Por pozita, e zgjodhi rrugën tjetër, duke e kushtëzuar formimin e komisionit që paraprakisht u dakorduar me kryetarin dhe shefat e grupeve parlamentare në zyrën e kryetarit, dhe rrjedhimisht duke e obliguar opozitën ta lëshoj seancën, si masë demokratikë për mospajtimin e formimit të komisionit. Nuk u mjaftuat me këtë por dolët me deklaratë në Radio Alba, duke i interpretuar sipas dëshirës suaj faktet. Personalisht, asnjë koment nuk e kam bërë në media sociale për këtë. Pas dy jave, me 14.04.2019, banorët e fshatit Çabiq, problemet e paraqitura në punimet e rrugëve të fshatit, fotografojnë barin e jashtëzakonshëm që brenda 4 muajve, pas shtrimit të asfaltit, arrin të mbijë si kërpudhat pas shiut, midis asfaltit, dhe që më pastaj behet lajm hit për humor të zi, në mbar Kosovën, e besa edhe më gjerë. Për të mos mjaftuar vetëm bari, ky asfalt lehtësisht largohet me dorë si me qenë nga letra dhe publikohet në facebook nga banorët! Për tu fshehur gjurmët e punimeve të pranuar teknikisht dhe të paguara nga Komuna, nuk u ndjek dhe respektua asnjë procedurë, as nuk i është dukur që po humb kohë pozitës, por urgjent të nesërmen, drejtori e ç' bëri një pjesë të asfaltit në Çabiq, që për krejt periudhën e pasluftës nuk e di se ka ndodh të hiqet komplet asfalti dhe të mos dihet nëse ka pas asfalt aty. Nuk po di si ta komentoj këtë veprim! Me lejoni Para se ta përfundoj këtë deklaratë, ti bëjë thirrje kryetarit, si personi përgjegjës dhe i mandatuar nga qytetarët e Klinës, që të merr të gjitha masat për sanimin e punimeve të punuara shkel e shko, sa më parë që të ketë mundësi, jo vetëm në Çabiq por edhe në Krushevë të Madhe, Gremnik, dhe në të gjitha rrugët e fshatrave të Klinës të ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm dhe të sanoj problemet, dhe të mos lejoj pranimin e punimeve pa plotësimin e standardeve elementare, e aq më pak të pranoj të bëjë pagesat si në rastin e Çabiqit. Edhe diçka tjetër që duhet ta mbajmë si "vath në vesh": Të gjithë ne, pozitë e opozitë, çdo punë e keqe si këto në rrugët e Klinës, e vrasin direkt shpresën e njerëzve, se në Kosovë do të bëhet mirë. Nuk po them që është arsyeja kryesore që të rinjtë po e braktisin Kosovën, por është një shtytës bukur i Madh që qytetarët të dorëzohen dhe ta lëshojnë vendin, kur shohin gjëra të tilla në shekullin 21.

Për fund. Kryetar, për të gjitha punët e mira që bëhen dhe mund të bëhen në Klinë nga punonjësit e komunës, mësimdhënësit, mjekët, policët, zjarrfikësit, e qindra e mijëra njerëz tjerë, meritat ju adresohen juve! Por edhe për të gjitha dështimet që janë bërë dhe mund të bëhen në Klinë, do ju adresohen juve, prandaj të lutem që të ushtroni të drejtën tuaj dhe të merrni hapat e nevojshme që Klinë mos të bëhet temë diskutimi për të keq, si në këtë rast. Ju faleminderit.

Kryesuesi z. Gashi e falënderon anëtarin e kuvendit z. Avni Gashi dhe fton anëtarët e tjerë nëse dëshirojnë të shtojnë gjë në lidhje me rendin e ditës.

z. Tunë Dedaj: Për Rendin e Ditës nuk kam për të shtuar asgjë por nëse bënë dy fjalë rreth kësaj që sapo e lexoi kolegu Gashi.

z. Enver Berisha: I nderuar kryesues, kjo që lexoi kolegu ishte Deklaratë. Nëse i jepet mundësia një anëtar tjetër që të debatoj për Deklaratë, atëherë po e bëjmë debat.

z. Fadil Gashi, kryesues: Jo, për deklaratë nuk bëhet debat prandaj kalojmë në Rendin e Ditës. Për Rendin e Ditës nëse keni për të thënë apo shtuar, urdhëroni.

z. Enver Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Edhe ne i kemi analizuar ato dy pika të rendit të ditës dhe kemi konstatim të njëjtë me juve kryesues, prandaj jemi dakord që ato dy pika të rendit të ditës të hiqen.

z. Petrit Palushaj: Përshëndetje për gjithë të pranishmit. Në lidhje me rendin e ditës, edhe në si grup I AAK-së pajtohemi që të procedojmë me këtë rend dite me ndryshimet e propozuara nga kryesuesi.

Kryesuesi, z. Fadil Gashi e venë në votim Rendin e Ditës me dy ndryshimet e propozuara dhe me 26 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET Rendi i Ditës.

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës për periudhën janar-mars 2019
(ref. Drejtoria e FEZH)
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- rregullores për themelimin dhe strukturimin e
Asamblesë Komunale të Fëmijëve (ref. Drejtoria e Arsimit),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për transferim të mjeteve(ref. Drejtoria e FEZH)
7. Shkarkimi dhe themelimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të bursave për studentë.

Pika e 1. E Rendit të Ditës: Arsyetimi i Mungesave

Kryesuesi, z. Gashi, informon se përveç anëtarit Baki Gashi, i cili ka arsyeshmëri të mungesës , për mungesën e të tjerëve nuk ka asnjë informim.

Pika e 2. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Procesverbali i seancës së kaluar miratohet pa asnjë vërejtje me 26 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e 3. E Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje.

z. Xhevgjet Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Unë kam dy pyetje. Një e kam për drejtorin tim, Skënder Merturi dhe një për drejtorin e Arsimit, Arben Limani. Pyetja e parë: Sa i përket subvencionimit të bërë për klubet sportive, duke u nisur nga ekipi i futbollit të femrave të cilat i kanë gjithsej 12 ndeshje në vit dhe janë në vendin e dytë në tabelë, për këtë klub ju keni nda vetëm 3000 euro. Po ashtu edhe për klubin e hendbollit i keni nda 3000 euro, edhe ky ekip i ka gjithsej 16 ndeshje në vit dhe është në vendin e tretë në tabelë. Përkundër që ekipi i basketbollit është në pozitën e parafundit në tabelë dhe i keni ndarë 4000 euro. Janë edhe ekipet e tjera për të cilat ju i keni ndarë vetëm 1000 euro dhe të cilat janë në pozita renditëse shumë më të mirë se basketbolli, kanë ndeshje më shumë në vit. Nuk e di se çfarë kriteri keni përdorë për këto ndarje. Te klubi i futbollit për femra, garojnë dy ekipe. Senioret janë në vendin e 4 në super ligë, dhe mosha U16 që janë në vendin e dytë po në super ligë. Gjithsej në vit, këto ekipe i zhvillojnë 40 ndeshje. Jam gati të jua sjell komplet raportin e shpenzimeve dhe faturat prej Bankës, që tregojnë se vetëm për lojtarë pagesa bëhen rreth 9000 euro. Nëse do të merrej për bazë numri i ndeshjeve dhe shpenzimeve, klubi i femrave në futboll do të duhej të subvencionohej me 12.000 euro. Sepse është 4 fishi i ndeshjeve dhe 4 fishi i stafit të lojtarëve. Të lutem tregomë se cilin kriter e ke përdorë që ta bësh këtë ndarje të mjeleve?

z. Skënder Merturi, drejtor i DKRS: Faleminderit. Ajo ndarje është vendim i komisionit dhe ne jemi të obliguar që ta respektojmë vendimin e tij. Për herë të parë është bërë me thirrje publike ashtu siç na obligon rregullorja dhe udhëzimi administrative. Ka qenë e përcaktuar koha e ankesave.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Kjo që e sqaroi drejtori, qëndron. Të gjithë ata që kanë aplikuar, ne, jemi të detyruar që ta respektojmë të drejtën e tyre për ankesë. Për çdo rast, ne do të kemi debat për raportin e 6-të mujorit të parë edhe për ndarjen e subvencioneve.

z. Xhevgjet Berisha: Përshëndetje për drejtorin e Arsimit. Unë kam një shqetësim sepse jam në procesin arsimor. Konkursët që po hapen - a duhet që së pari të mbulohen me orë punëtorët të cilët janë në proces dhe janë përkatës për ato orë, apo për të plotësuar premtimet gjatë fushatës elektorale të hapim konkurs, duke i lënë të tjerët që janë në proces dhe kanë kualifikim përkatës, pa plotësim norme? P.SH. është rasti i mësuesit Alban Millaku dhe Xhevdet Kadriu, të cilët japin lëndën e Edukatës Fizike. Për këtë lëndë është hap konkurs ndërkohë që këta nuk e kanë normën e plotë dhe janë të kualifikuar. A ekziston një e drejtë ligjore që të veprohet kështu?

z. Arben Limani, drejtor i DKA: Përshëndetje të gjithëve. Rasti i arsimtarëve që i përmende, ka shkuar ankesa në inspektoratin e punës. Ne e kemi marr një shkresë nga inspektorati në fjalë për anulimin e konkursit.

z. Petrit Palushaj: Dëshiroj që edhe unë të ndërlidhem tek subvencionet e klubeve sportive. Meqenëse ende nuk është bërë publike dhe nuk kemi zhvilluar debat publik, po e rezervoi pyetjen time për drejtorin e DKRS, për seancën e ardhshme.

z. Isa Ibishi: Përshëndetje për të gjithë. Pyetje për drejtorin e Kulturës: A ke qenë ndonjëherë në Palestrën Sportive? Është mirë me ndërmarr masa që të pastrohet hapësira para dhe për rreth Palestrës. Është duke u dëmtuar shumë gjelbërimi i Palestrës. I ke 6 punëtorë në këtë aset, që nuk e kanë komunat e tjera, prandaj është mirë që të kujdeseni më shumë.

z. Skënder Merturi, drejtor i DKRS: Ato kubëza, atë zhavorr ose më mirë më thënë ai bërlllok është krijuar nga qeverisja e kaluar dhe ne jemi duke bërë përpjekje që ta eliminojmë. Pra, e kemi parasysh

këtë problematikë, e kemi diskutuar edhe në bord të drejtorëve dhe jemi duke bërë përpjekje. Përndryshe në Palestër shkoi shumë shpesh dhe jam tërësisht i njoftuar për çdo gjë rreth sajë.

z. Avni Gashi: Pyetje për drejtorin e kulturës z. Skender Merturi, në lidhje me marrjen e vendimit për themelimin e këshillit organizativ për Festivalin tradicional "I këndojmë Lirisë". Lërja anash e figurave të kulturës së Komunës sonë, që për çdo vit kanë kontribuar në baza vullnetare për organizimin dhe mbarëvajtjen e festivalit, i krijon të gjitha parakushtet që festivali tradicional "I këndojmë Lirisë" të dështon. Mos përfshirja në këshillin organizativë, të figurave si : Idriz Berisha, Prend Buzhala, Dibran Fyellit, Ismet Krasniqi, Gjoin Gjergji, Halit Gashit, Fatmir Berisha, Zeke Gashi, Skënder Behrami, e shumë figurave tjera të çmueshme, që Klina i ka, krijon parakushte që ky festival të dobësohet jashtëzakonisht shumë. E në anën tjetër, të vendosen në krye të festivalit njerëzit e politikës, ky është degradim i festivalit! Duke marr shkas nga këto, pyetja për drejtorin : 1. Nëse këshilli organizativ prej 50 vetave në vitin e kaluar ka dështuar, drejtori le të na tregoj se pse ka dështuar ose kush nuk i ka kryer punët si duhet, sepse parat e dedikuara për këtë festival janë shpenzuar me centë, njëjtë sikurse në vitet paraprake. Dhe, 2. Pse e keni anashkaluar komplet rregulloren e komunës të nxjerr me 23.04.2013, përpiluar nga këshilli organizativ i festivalit dhe i aprovuar nga kryetari?

z. Fadil Gashi, kryesues: Që të të ndihmoi pak në lidhje me këtë çështje. Në seancën e kaluar, ne, nuk ju kemi referuar rregullores por vendimit të Kuvendit, i cili është në fuqi derisa nuk anulohet nga Kuvendi dhe të nxirret një vendim tjetër. Me atë vendim, për organizimin e festivalit ngarkohet vetëm Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Drejtoria pastaj sipas nevojës angazhon trupa shtesë. Këtë sqarim doja ta bëjë. Nëse ju ka referuar rregulloreve është gabim teknik. Sa i përket shpenzimeve të festivalit, ju e dini, e keni pasur raportin financiar për festivalin e vitit të kaluar në Kuvend.

z. Asdren Ramadani: Po jua paraqes një shqetësim të Madh për rrezikun e jetës së qytetarëve. Fjalën e kam për një pemë-plep që gjendet para hyrjes së Gjimnazit. Ka një vit e gjysmë që banorët e asaj lagjeje kanë bërë kërkesën për prerjen e atij plepi, pasi që aty kalojnë telat e tensionit të ulët dhe të lartë të energjisë elektrike. Deri me sot nuk është ndërmarr asgjë. Këtë të shtunë, me dt. 27 prill, era e theu degën dhe i këputi edhe telat e energjisë por për fat të mirë nuk kishte as nxënës dhe as kalimtarë të rastit që mos të bëhej fatale. Çka mund të jetë më prioritet se sa veprimi për evitimin e rrezikut që i kanoset jetës së banorëve dhe nxënësve, që çdo ditë frekuentojnë shkollën. Zoti kryetar, ju lutem që të ndërhyni menjëherë pasi që kjo punë nuk pret.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Faleminderit Asdren. Ajo pemë është e vendosur në kuadër të oborrit të shkollës së mesme dhe mendoi që përgjegjësia do ti takonte më shumë organeve të shkollës për veprim. Sidoqoftë, unë jam i lumtur që s'ka pasur pasoja në njerëz dhe them se gjithsesi do të merremi me këtë problem.

Znj. Xhezide Trepça-Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Unë kam një kërkesë për drejtorinë e Arsimit. Në shkollën fillore "Motrat Qiriazit", karriget dhe bankat janë të vjetruara, të dëmtuara dhe ka mungesë të tyre. Kjo shkollë ka nevojë për banka dhe karrige të reja dhe nëse tani nuk ka mundësi të sigurohen, të paktën të sigurohen në fillim të vitit të ri shkollor.

z. Arben Limanaj, drejtor i DKA: Që ka mungesë nuk e besoi, por se janë të vjetruara dhe të dëmtuara, po. Nuk kemi mundësi që ta bëjmë ndërrimin e tyre në të gjitha shkollat. Aty ku është më e nevojshme, ndërhyjmë vazhdimisht.

z. Sefa Morina: Unë kam një pyetje për drejtorin e Arsimit, Arbenin. Drejtor, ju po e shihni që shumë qytetarë po e braktisin vendin. A mund të na tregoni në seancën e ardhshme, se gjatë këtij mandati, sa nxënës e kanë braktisur procesin mësimor? Kjo s'ka të bëjë me punën ose mos punën tuaj por me seriozitetin e ngjarjes.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Nuk e pata plan që të flas fare por më bëri përshtypje përgjigja e drejtorit të Kulturës, që ja dha anëtarit të Kuvendit, Isa Ibishi. Drejtor, dëmtimi i gjelbërimit, që po bëhet aty, s'ka të bëjë me qeverisjen e kaluar, nuk ka qenë keq gjelbërimi aty, por edhe nëse ka qenë keq, nuk duhet të thirresh në të kaluarën. Ti je i zgjedhur për me e bërë mirë. Kështu që plotësisht pajtohem me kërkesën e Isa Ibishit.

Pika e 4. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës për periudhën janar-mars 2019.

Për raportimin financiar për këtë periudhë kohore, kryesuesi, z. Gashi, fjalën ja jep drejtorit të FEZH, z. Aziz Desku.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Përshëndetje për të gjithë. Më lejoni që të prezantoj një raport të shkurtër në lidhje me menaxhimin financiar për periudhën janar-mars të vitit 2019. Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar – mars 2019 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Raporti për periudhën janar-mars 2019, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave. Buxheti në këtë periudhë ishte 10,019,526.84 €. Siç shihet nga tabela që ju e keni në raport, buxheti sipas SIMFK për janar- mars 2019 është më i lartë për rreth 3.91 % se buxheti në periudhën e njëjtë të vitit 2018.

1. Granti Qeveritar- Granti Qeveritar është burimi kryesorë i financimit të buxhetit komunal që shihet edhe në tabelë, ku pjesëmarrja është 90.70% në vitin 2019 (vlera 9,087,384.01). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 5.54 % më i lartë. Nga kjo nënkuptohet se jemi të varur nga ky burim i financimit.

2. Të Hyrat Vetanake- Siç shihet edhe në tabelë buxheti nga THV është 921,144.00 € (9.19 %) e buxhetit total në këtë periudhë. Ndërsa në raport me vitin paraprak buxheti nga THV është më i ultë për 10.39 % Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe Donacionet e bartura siç janë :

- Participimi i qytetarëve në vlerë 5,742.31€, në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetar është 38.19 % më i lartë se në vitin paraprak

- Donacionet e jashtme të bartura janë në vlerë 5,256.51 €.

Buxheti i shpenzuar në periudhën janar –mars 2019 në vlerë 1,771,415.54 € është 17.68 % e buxhetit në SIMFK në periudhën janar- mars 2019. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 1,733,151.69 € (19.07 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 34,157.54 € (3.71 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2019), participimi i qytetarëve 2,100.00 € (36.57% në raport me buxhetin nga participimi i qytetarëve) dhe 2,006.31 € (38.17% në raport me buxhetin nga Save the

Children). Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 1,771,415.54 € nga granti qeveritar janë shpenzuar 97.84 % , nga të hyrat e vitit 2019 janë shpenzuar 1.93 % , nga participimi i qytetarëve 0.12% dhe nga Save the Children 0.11 % . Krahasuar me vitin 2018 , shpenzimet për këtë periudhë janë më të larta për 0.89% .

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – mars 2019 në vlerë 1,771,415.54 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,476,038.84 € (24.42% në raport me buxhetin për paga), për mallra e shërbime janë shpenzuar 182,111.26 € (18.99% në raport me buxhetin për mallra e shërbime), për shërbime komunale janë shpenzuar 31,342.12 € (17.41% në raport me buxhetin për shërbime komunale, për subvencione janë shpenzuar 3,160.00 € (3.01% në raport me buxhetin për subvencione dhe për kapitale janë shpenzuar 78,763.32 € (2.88% në raport me buxhetin për kapitale). Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 1,771,415.54 € , për paga e mëditje është 83.33 % e shpenzimeve , për mallra dhe shërbime është 10.28 % e shpenzimeve , për shërbime komunale është 1.77 % e shpenzimeve , për subvencione është 0.18 % e shpenzimeve dhe për kapitale është 4.45 % e shpenzimeve . Shpenzimet në periudhën janar-mars 2019 në vlerë 1,771,415.54 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2018 në vlerë 1,755,723.88 € janë rrit për rreth 0.89 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë rrit për 1.09% , shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritë për 46.35 % , shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për 5.50 % , shpenzimet për subvencione janë zvogëluar për 34.17 % dhe shpenzimet për kapitale janë zvogëluar për 40.85 % . Ju faleminderit për vëmendjen, për ndonjë sqarim shtesë jam në dispozicion.

Kryesuesi I Kuvendit hap debat rreth raportit financiar.

z. Petrit Palushaj: Tek shpenzimet buxhetore për periudhën Janar-Mars 2019, në këtë tabelar, kërkoi nga drejtori disa shpjegime sepse nuk i pata shumë të qarta. Tek shërbimet kontraktuese, shpenzime të tjera- 40.000 eu e që krahasuar me vitin 2018 këto shpenzime në këtë kategori kanë qenë 25.000 eu. Edhe shpenzimet për anëtarësim 7.600 eu, nuk e kuptoi se për çfarë anëtarësimi bëhet fjalë pasi që në vitin 2018 shpenzimet për anëtarësim kanë qenë 00. Shpenzimet për mobileje që janë gjithashtu më shumë se në vitin e kaluar, do të doja të dija se ku janë blerë këto mobileje, cila drejtori i ka blerë. Edhe shpenzimet tek pajisjet e tjera do të doja që ta specifikoni se çfarë nënkupton “të tjera”. Ndërkohë që sivjet shpenzimet mjekësore janë më të vogla se vitin e kaluar, pikërisht kjo më shqetëson pasi që kemi nevojë që në këtë sektor të ketë më shumë furnizime, më shumë rregullime dhe si rrjedhojë më shumë shpenzime. Në karburante gjithashtu ka ngritje të shpenzimeve për rreth 2000 euro krahasuar me vitin e kaluar, edhe për këtë do të doja që të na e sqaroni më në detaje. Këto janë disa shqetësime që unë i kam vërejte në bazë të tabelorit. Ndoshta nuk kam informacionet e duhura.

z. Fadil Gashi, kryesues: Para se ta merr fjalën drejtori, kam një kërkesë në emrin tuaj të nderuar anëtarë, që raportet e radhës të na i sjellin të detajuara këto shpenzime. D. m. th, të specifikohen sipas drejtorive.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Unë konsideroi që për një pjesë të këtyre kërkesave për sqarime, ne e dhamë përgjigjen por për një pjesë tjetër unë do të mbaj shënim dhe në mbledhjen e ardhshme do të ju jap përgjigje. Shpenzimet për anëtarësim, është anëtarësimi i Komunës në Agjensionin Rajonal për Zhvillim-AZHR-perëndim ku participimi në këtë agjenci është 4000 euro. Tek shërbimet kontraktuese ku është një rritje pak më e madhe në krahasim me vitin e kaluar, unë e dhashë një sqarim por po e zgjeroi pak. Bëhet fjalë, pra, për shpenzimet në mirëmbajtjen e objekteve. Gjithashtu në këtë kategori futen

edhe shpenzimet për dekorimin e qytetit për fund vit, si dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e kamerave në qytet, pastrimin e borës dhe mirëmbajtja e shkollave. Shpenzimet për pajisjet e tjera, bëhet fjalë për shpenzimet për gomat e automjeteve, radiolidhje për zjarrfikësit, printer në drejtori të ndryshme, mjetet didaktike në kuadër të shkollave dhe të tjera. Shpenzimet e karburanteve për vetura, janë pak më të mëdha por me siguri kjo si arsye e zhvillimeve më të mëdha në punë. Sa i përket shpenzimeve për mobileje, nuk e kam analizuar si shpenzim të veçantë, përgjigjen do ta keni në seancën e ardhshme. Besoi nuk kam harruar ndonjë gjë.

z. Petrit Palushaj: Faleminderit për shpjegim, drejtor. I kam të qarta deri diku. Tek anëtarësimi në odat e mjekëve dhe infermierëve, pse vitin e kaluar 50 euro shpenzime ndërsa këtë vit 1.900 euro. Edhe një herë na i ke shpjeguar por unë me siguri s'kam arrit që ta kuptoi.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Shpenzimet në këto oda janë sikurse shpenzimet e anëtarësimeve në organizatat sindikale të punëtorëve. Për me e parë më saktësisht se si ndalen këto mjete, e ftoi Petritin që të vije në zyre dhe ti shohë. Pse është 50 euro vitin e kaluar dhe këtë vit 1.900 euro, nuk e kam analizuar, përgjigjen do ta jap seancën e ardhshme.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kemi dëshirë që ta dimë të gjithë, jo vetëm Petriti.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Mendova që ta shikoi Petriti, teknikisht se si bëhet.

Z. Valmir Bacaj: Para se të hyjë tek shpenzimet për këtë periudhë, dua ta evidentoi një gabim teknik. Faqe nr. 6. Kolona nr. 3. e raportit: Shpenzimet janar-mars 2018, duhet të ishte: Janar-Mars 2019. Për raportin në fjalë, ne si grup kuvendarë e konsiderojmë si një performancë të mirë buxhetore. Nëse i marrim dy shtyllat e buxhetit të Komunës së Klinës, e që janë, të hyrat buxhetore për periudhën janar-mars 2019 dhe tek shpenzimet, atëherë mund të konkludojmë se kemi rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe për shpenzimet të cilat nuk janë shumë më të mëdha, si 0.89%. E konsiderojmë sukses të qeverisjes dhe menaxhim i mirë i buxhetit Komunal.

Znj. Violeta Zefi: Përshëndetje për të gjithë. E falënderojmë drejtorin për shpjegimin e nevojshëm në lidhje me raportin financiar për periudhën, janar-mars 2019. Dua të ndalem shkurtimisht tek të hyrat e realizuara në këtë periudhë kohore, krahasuar me periudhën e vitit paraprak, pikërisht tek faqja 9. Kolona 22. Ku evidentohet participimi në shëndetësi dhe vërehet një rritje e ndjeshme krahasuar me vitin 2018. Me një vrojtim të thjeshtë, pa një analizë të detajuar, shihet që të hyrat janë të vogëla kur të merret parasysh numri i vizitave që realizohet në QKMF, e sidomos në këtë periudhë kohore për të cilën po flasim, pasi që në këtë periudhë kohore duke qenë aktual gripi sezonal, ka pasur vizita më të shumta. Jam e informuar për lirin nga participimi i një kategorie të qytetarëve por gjithsesi mendoi që shumica e të hyrave është e vogël që mos të them jo reale.

z. Isa Ibishi: Drejtor i nderuar, ju vlerësoi si profesionist, por unë ose kam nevojë që të sqarohem ose është ajo që mendoi se është një trend jo i mirë i të hyrave dhe shpenzimeve. Në bazë të shënimeve që i kam të dhëna nga ju, del që në janar-mars 2018, të hyrat janë 209.007.00 euro, dhe kur krahasohet me 2019, diferenca është vetëm 188 euro, të hyra. Pa dashur që të futem në detaje, vetëm sa për vëmendje, prej 27 pikave të paraqitura këtu, 14 janë negative. D.m.th. Shpenzimet buxhetore sipas këtij raporti, për periudhën, janar-mars 2019, janë më të mëdha krahasuar me 2018 për 15.691.00 euro. Pra, është një trend jo i mirë edhe i të hyrave edhe i shpenzimeve. Ato që i tha kolegu, Palushaj, por edhe ju kryesues, që në tre mujorin e dytë të sillen veç e veç sipas drejtorive shpenzimet e bëra është vërejtje a

kërkesë më vend, sepse vërtetë s'ka kuptim që të shpenzohen 40.000 euro dhe të mos dihet se për çka janë shpenzua dhe kush i ka shpenzuar. Absolutisht nuk dua të bëjë krahasime qeverisjesh, por vetëm sa për informim, shikoni vitin 2017, për këtë periudhë kohore, të hyrat vetanake janë 2018,3402.00 euro dhe shpenzimet janë shumë, shumë më të vogëla se sa që janë në 2018. E vlerësoi profesionalizmin e juaj drejtor por është mendimi i imi se as të hyrat dhe as shpenzimet për këtë vit, në këtë periudhë, nuk janë menaxhuar mirë. Dua të jem konstruktiv por jam i prirur që asaj që nuk është mirë të mos i them e mirë dhe anasjelltas.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Sa i përket raportit të të hyrave, unë mbeta mangut dhe nuk e sqarova deri në fund. Në materialin që e keni ju nuk janë të përfshira të hyrat nga gjobat e trafikut dhe gjykatave. Nëse i përfshijmë të gjitha, për periudhën, janar-mars 2019, të hyrat e realizuara janë 226. 596.00 euro. Në vitin 2018 kanë qenë 221. 272.00 euro. Sa i përket trendit të të hyrave, unë nuk e bëra bujë të madhe, se paskemi bërë kush e di sa, por këto të hyra janë pak më të mëdha se sa vitin e kaluar. Në tre mujorët e ardhshëm diferenca do të jetë edhe më e madhe dhe në fund të vitit do të arrijmë që ti realizojmë dhe tejkalojmë planifikimet. Sa i përket shpenzimeve, krahasuar me planifikimet e shpenzimeve për këtë periudhë, jemi nën shpenzimet e planifikuara. Për këtë tre mujor kanë qenë të planifikuara 25%, ndërsa ne jemi tek 17%. Pra, mendoj që është performancë pozitive. Përveç kategorisë së pagave që shpenzimet janë më të mëdha se sa që janë planifikuar, të gjitha kategoritë e tjera janë më të vogëla. Edhe një herë, derisa nuk kemi arritë që ti tejkalojmë shpenzimet e planifikuara por përkundrazi jemi nën planifikimin e shpenzimeve, mendoj që është performancë pozitive.

z. Gjokë Lleshaj: Përshëndetje për gjithë të pranishmit. E morëm një raport të pa qartë, përkundër besimit të madh që kemi në përgatitjen profesionale që kemi në drejtorin e FEZH. I pa specifikuar dhe që më pastaj po jepen sqarime por që do të duhej të ishin të evidentuara në raport. Me marrjen e mandatit keni premtuar qeverisje ndryshe, në vazhdimësi keni përmendur disa lloj rekordesh por nga rekorde keni kaluar në çrekorde. Nuk është një raport me të cilin mund të mburreni. Është I mangët dhe I paqartë. Uroi që të na sjellin raporte ndryshe në të ardhmen.

z. Enver Berisha: Edhe unë po e filloi me drejtorin, z. Desku, duke e pasur parasysh se tani e një vit më parë, kur është bërë prezantimi i raportit, përveç shifrave të prezantuara, drejtori bënte edhe politikë me ato shifra. Raportohej vetëm për ato ndryshimet pozitive, duke tentuar që të tregohet se këtu ka me ndodhë mrekullia. Gjë e cila është e pamundur të ndodhte, sepse ne jemi këta njerëz që kemi qenë këtu tash e 19 vjet. Herë në AAK, herë në LDK e herë në PDK. I dimë të gjitha zhvillimet se si ndodhin, sikurse edhe forma e planifikuar e buxhetit nga qeveria. Realisht dihen kufijtë se sa mundemi me mbledhë të hyra dhe sa janë kufijtë e shpenzimeve. Nëse merret dhe analizohet ky raport që po thuhet se dikush e ka ndryshe, unë e kam versionin e parë, pa dashur me hyrë në detaje sepse shumë gjera u thanë, ajo që ka ndodhë si rritje e shpenzimeve është shumë interesante. Në ato shifra që janë rritur shpenzimet, në asnjë segment nuk kanë përfituar qytetarët e Komunës së Klinës. Nga këto shpenzime të rritura është administrata dhe shërbimet e veta që ka përfituar, derivate, telefona, mobileje etj. Asnjë cent nga këto rritje të shpenzimeve nuk ka shkuar në të mirë të qytetarëve. E keqja është se nuk ka rritje të shpenzimeve në projektet kapitale, këtu do të duhej të kishte rritje që të kuptohej se po punohet për qytetarin. Edhe unë jam dakord me parafolësit se ky raport është paksa konfuz, I pa shpjeguar mirë për rrjedhjen e parasë publike. Krejt në fund, unë nuk po dua që ta përfundoi vlerësimin e këtij raporti për faktin se u kërkua që të vijnë shpenzimet e detajuara dhe të ndara sipas drejtorive. Pasi të analizohen shpenzimet në secilën drejtori, do të bëhej vlerësimi dhe të merret vendim se a duhet të votohen këto

shpenzime apo jo. Pra, kryetar dhe kryesues, po insistoi që kjo pikë mos të vihet në votim sot por në një seancë tjetër, pasi të sjellët një raport i detajuar dhe i ndarë veç e veç sipas drejtorive.

z. Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Enver. Sa i përket Azizit, me pas mundësi me e shti me folë për politikë do të doja edhe unë por ky nuk flet për politikë. Ndërsa sa i përket kërkesës për veçim të shpenzimeve sipas drejtorive, thënë të vërtetën edhe ne kur kemi qenë në opozitë e kemi kërkuar që të bëhet ashtu. Dhe po insistoi që anëtarëve të Kuvendit të ju vije raporti i detajuar dhe i ndarë sipas drejtorive. Por, ju po e shihni se bëhet fjalë për shqyrtim të raportit dhe jo votim. Nuk votohen më raportet financiare tre mujore. Vetëm Raporti i ekzekutivit në fund të vitit votohet.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Së pari dua ta kontestoi atë që e deklaroi Gjokë Lleshaj, se ka rënje për 10% , s' di ku e ka marr atë përqindje e shifër. Unë edhe një herë po e deklaroi se të hyrat e realizuara për periudhën, janar-mars 2019, me gjitha participimet, me gjoba gjykatash etj, janë 226.596.00 euro, ndërsa për vitin 2018 kanë qenë 221. 172.00 euro. Pra është një rritje prej 5.424,00 euro. Ky është realiteti, i madh apo i vogël ky është ndryshimi. Për shpenzimet e vogëla për investimet kapitale, unë e ndaj shqetësimin e njëjtë me Enver Berishen, por Enveri e din mirë se buxheti në nivel qendror është aprovuar diku në muajin shkurt të vitit 2019. Pa u aprovuar ai buxhet, s' ka pas teori që të shpenzohen mjete. Përveç kësaj, ne në mbledhjen e kaluar kemi marr vendim për bartjen e mjeteve nga viti 2018 në vitin 2019, kjo është realizuar tek në javën e kaluar dhe s' ka pasur asnjë mundësi që të shfrytëzohen ato mjete për periudhën Janar-Mars. Përndryshe, ky është një raport i paraqitur ashtu qysh e nxjerr sistemi i menaxhimit financiar. Ne u dakorduam që raportin e shpenzimeve veç e veç sipas drejtorive ta shpërndajmë në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

z. Enver Berisha: Kryesues, meqenëse mu përmend emri, më jepni mundësinë e një pyetje për drejtorin. Çfarë ka më pozitive në këtë tre mujor të këtij viti me tre mujorin e vitit të kaluar?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Vërtetë qëndron konstatimi se raporti financiar duhet të vije i specifikuar sipas drejtorive. Gjithashtu mendoi që është vështirë të bëhen krahasime tani për periudhë tre mujore. Krahasimet e vërteta do të bëhen në fund të vitit. Gjithsesi, jemi të hapur për vërejtjet e juaja për çdo shpenzim buxhetor, edhe vërejtjet që u thanë sot këtu do të shqyrtojmë në mbledhjen me drejtorë dhe aty ku ka mundësi që të zvogëlohen shpenzimet, do të zvogëlohen por konstatimi im është se unë nuk mburrem me zvogëlime të shpenzimeve sepse i bije të mos kemi punuar sa duhet. E shpjegoj edhe drejtori se si nuk është arritë që të shpenzohet buxheti shkaku i aprovimit të buxhetit dhe të tjera, mendoi që në tri periudhat e tjera, do të arrijmë që të jemi ekuivalent me planifikimet e shpenzimeve.

z. Gjokë Lleshaj: Drejtor, unë këtë raport nga ju e kam marr. Këto shifra janë të vërteta, nuk po të fajësoj ty pse s'keni arkëtuar më shumë. Sipas këtij raporti që e kanë edhe të tjerët po shihet se të hyrat nuk janë në masën e vitit paraprak.

z. Fadil Gashi, kryesues: Keni të drejtë të dy palët. Ju i referoheni një kategorie që është e saktë- të hyrat vetanake që janë 10% më pak. Azizi i referohet të përgjithshmes dhe edhe ai ka të drejtë.

z. Valmir Bacaj: Në fjalimin tim e thash se ka rritje të hyrave buxhetore për 3.91% në total. Pas fjalimit tim, foli Gjokë Lleshaj i cili tha se ka zvogëlim të hyrave buxhetore. Meqenëse jemi drejt për drejt në Radio ALBA, është mira ta sqarojmë këtë mospajtim. Gjoka është duke ju referuar vetëm një kategorie buxhetore, asaj të të hyrave vetanake e që është e vërtetë që ka zbritje për 10.39%, por nëse e shohim tabelën sqaruese tek të hyrat vetanake, atëherë kemi 17% të hyra nga taksat për leje ndërtimi. Ne nuk

mund ti detyrojmë njerëzit që të bëjnë ndërtime. Edhe tek taksat e kurorëzimit ka zbritje porse as këtu nuk mund të insistojmë. Mos të krijojmë paqartësi, në total kemi rritje të të hyrave buxhetore.

z. Enver Gashi: Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket raportit në fjalë, tek disa kategori kemi rritje të shpenzimeve dhe tek disa kategori të tjera ka zvogëlim. Ashtu siç e tha edhe drejtori, në përgjithësi krahasimi 2018 me 2019 është i njëjtë. Ajo që dua të them është se duhet të bëjmë përpjekje që sa më shumë ta ruajmë paranë publike.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nëse s' ka askush tjetër për të debatuar, po e ritheksoi se mbetet që për seancën tjetër të pajiset secili anëtarë me raportin e shpenzimeve veç e veç sipas drejtorive.

Pika 5. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (ref. Drejtoria e Arsimit)

z. Fadil Gashi, kryesues: Këtë draft-rregullore e kemi shqyrtuar edhe në KPF, nëse ka për të shtuar ndonjë gjë drejtori i Arsimit, le të urdhëroi. Po hap debat.

z. Enver Berisha: E kemi shqyrtuar këtë draft-rregullore dhe mendimin tim e kam dhënë edhe në KPF. E konsideroi si domosdoshmëri këtë rregullore dhe në aspektin e përgatitjes dhe kompletimit të këtij dokumenti nuk kam vërejtje. Teknikisht dhe juridikisht mendoj që është e kompletuar dhe ne si grup i PDK-së e mbështesim.

z. Enver Gashi: Gjithashtu edhe grupi i ynë i LDK-së e mbështetë këtë draft-rregullore për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

z. Petrit Palushaj: Në emër të grupit të AAK-së e mbështesim miratimin e kësaj draft-rregulloreje.

Kryesuesi i Kuvendit, e venë në miratim Draft-Rregulloren në fjalë dhe me 22 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Pika 6. e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për transferim të mjeteve.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Drejtoria e Arsimit na është drejtuar me një kërkesë neve si drejtori por edhe KPF-së, për një transferim të mjeteve nga një program në një program tjetër. Kërkohet që të merret një vendim për transferimin e mjeteve në vlerë prej 6.000 euro nga programi i arsimit të mesëm, në arsimin fillor. Si dhe 2.500 euro nga arsimi para fillor në arsimin fillor. Ky transferim i mjeteve ndikon që mos të mbesin pa paga këto dy programe, dhe e përmirëson situatën në programin e arsimit fillor. Pra, është një procedurë normale marrja e vendimit të tillë e që më pastaj ne të kemi mundësi që ti drejtohem thesarit për këtë transfer.

z. Enver Berisha: Meqenëse jemi dakorduar edhe në KPF duke e pa si arsye e domosdoshme, jemi dakord këtij vendimi.

z. Petrit Palushaj: Gjithashtu edhe grupi i ynë në Kuvend, pajtohem që të marrim një vendim të tillë.

z. Gjokë Lleshaj: Drejtor a ka mundësi një sqarim se kush përfiton nga ky transferim?

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Për nevojën konkrete të bartjes së këtyre mjeteve, dua të them se gjatë planifikimit të buxhetit nuk është e mundur që të planifikohet 100% nevojat që do të rrjedhin gjatë vitit. Unë e shpjegova se ku dhe për çfarë është i nevojshme ky transferim, numrin e punëtorëve që do të përfitojnë nuk e kam.

Kryesuesi I Kuvendit e vënë në miratim dhe me 20 vota PËR, asnjë kundër dhe dy abstenime, MIRATOHET.

Pika 7. E Rendit të Ditës: Shkarkimi dhe themelimi I Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të bursave për studentë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ju e dini që ne e kemi një komision të themeluar për këtë qellim dhe se janë dy ankesa që duhet të shqyrtohen por këtij komisioni ekzistues I ka skaduar mandati prandaj ne sot duhet ta bëjmë shkarkimin dhe themelimin e komisionit të ri për shqyrtimin e këtyre ankesave. Studentët që kanë përfituar Bursa nuk mund ti tërheqin ato para se të përfundoj puna e shqyrtimit të ankesave. Prandaj ky komision që do ta themelojmë sot ka afat 15 ditë që ta kryej punën në tërësi. Kështu e thotë rregullorja. Ju kërkoi mirëkuptim edhe nga Komisioni I parë edhe nga I dyti por kërkoi edhe përgjegjësi nga ky Komisioni I tretë që do ta formojmë sot që ta kryej punën si duhet.

z. Tunë Dedaj: E kam shprehur shqetësimin tim edhe në KPF. Është vërtetë shqetësim që studentëve të ju vonohen bursat për shkak të mos kryerjes së punës nga ana e Komisionit. Prandaj , pajtohem për formimin e Komisionit të Ri dhe ftoi atë komision që mos të presin afatin prej 15 ditëve por brenda dy-tre ditëve të sjellin vendim dhe studentët të marrin bursat që jua ka nda Kuvendi.

z. Valmir Bacaj: Edhe në seancën e kaluar e kam ngritë këtë shqetësim dhe vërtetë është e pa kuptimtë kjo vonesë për ndarjen e bursave. Mos të harrojmë se kanë përgjegjësi edhe ata që nuk e kanë kryer punën por edhe ky komision që ka me u votuar sot. Ato dy ankesa nuk marrin më shumë kohë se 10 minuta, nuk është mirë të ndikohet politikisht komisioni por ta kryej punën në mënyrë profesionale.

z. Enver Berisha: Realisht është shqetësuese kjo që po ndodhë dhe jo vetëm me këtë komision por edhe më komitetet-komisionet e tjera përjashtoj KPF-në. Pse po ndodhë kështu? Sepse ka neglizhencë në pagesën e anëtarëve të Komisioneve. Puna vullnetare ka mbaruar. Gjithashtu kërkoi nga kryesuesit e këtyre Komisioneve që të jenë aktiv dhe të arsyetojnë formimin e Komisionit. Ne në asamble akoma asnjë kërkesë nuk e kemi marrë nga këto Komisione. Pse po formojmë Komisione nëse nuk paguhen sipas rregullores dhe vendimeve si dhe as ato komisione nuk e kryejnë punën. Një çështje tjetër. Po I lutem edhe kryetarit edhe kryesuesit, përjashtoj këtë komision që do ta formojmë sot, nëpër komisione të tjera po ka shpërputhje të përfaqësimit të opozitës. Unë e di që Pozita mund ti formojë edhe vet Komisionet por dua të bëjë thirrje që mos të llogaritet vetëm PDK si Opozitë pasi që janë edhe disa parti të tjera që përfaqësohen këtu në Kuvend, në taborin e Opozitës. Përfaqësimi nëpër Komisione dhe organizime të tjera të jetë pak më i barabartë se sa që ka qenë deri me tani.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne, edhe sot e kemi debatuar me drejtorin, Aziz Desku. Nuk është përgjegjësi e Komunës, nuk është se s' ka mjete që të paguhen anëtarët e Komisioneve që I kemi formuar por është Ministria e financave që s' po lejon të bëhen pagesat, Kjo është pengesa që na ka shoqëruar deri me tani.

z. Gjokë Lleshaj: Pajtohem për formimin e Komisionit për shqyrtimin e atyre ankesave dhe të kryhet puna dhe studentët të marrin bursat që ju kanë nda. Nuk pajtohem që s' po gjendet forma të paguhen anëtarët e Komiteteve dhe Komisioneve. Për shumë çka po gjendet forma, por, mendoi që është mos angazhimi dhe mos interesimi.

z. Fadil Gashi, kryesues: Asnjë arsye nuk kanë që mos të bëhet pagesa e këtyre Komiteteve dhe Komisioneve. Përkundrazi, duke mos bërë pagesat e tilla po shkelen vendimet e qeverisë së Kosovës.

Kryesuesi e vënë në votim shkarkimin e Komisionit paraprak dhe me 22 vota MIRATOHET shkarkimi.

Më pastaj shkohet në propozime për formimin e Komisionit të Ri, ku propozohen:

1. Suzana Gjergji - Ekzekutivi
2. Ajet Sejdiu – Ekzekutivi
3. Tahire Gashi – OJQ “Zana”
4. Blerta Gashi – AAK
5. Elvira Sejdiu – PDK

Ky Komision i propozuar vihet në votim dhe me 22 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET.

Në përfundim të seancës, anëtari i Kuvendit, z. Enver Berisha kishte një kërkesë në lidhje me kërkesën e diskutuar për dhënien e një raporti për ndarjen e subvencioneve për Klubet Sportive. Ai kërkoi që në seancën e Majit ta kenë atë raport, në mënyrë që për seancën e qershorit të jenë të përgatitur se çfarë duan të ndryshojnë dhe votojnë.

Në lidhje me këtë propozim-kërkesë nga anëtari i Kuvendit, kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, sqaroi mundësitë e përgatitjes sa më të mirë të këtij raporti edhe nga Drejtoria e Kulturës por edhe nga ata që kanë përfituar subvencione, duke pasur kohë më të madhe deri në seancën e qershorit. Më këtë konstatim u pajtua edhe anëtari i Kuvendit z. Enver Berisha, i cili bëri kërkesën e theksuar më lartë por edhe gjithë anëtarët e tjerë prezent në Kuvend. Pas kësaj, kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, i mbylli punimet e seancës së IV-të, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Klinës, duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe angazhim.

Procesmbajtës:
Skënder Behramaj



Kryesuesi:
Fadil Gashi

